



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 1, datë 18.01.2012

MBI

KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT PËR VITIN 2012

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nenit 45, paragrafi 4, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në bazë të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, nenit 45 “shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e RSH në sigurimin e detyrueshëm motorik, janë të detyruara të kontribuojnë çdo vit financiarisht në fondin e kompensimit, në përpjestim të drejtë me primet bruto të shkruara në këto lloj sigurimesh, në vitin paraardhës. Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Byroja Shqiptare e Sigurimit ka depozituar në Autoritet vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 84, datë 16.12.2011 me anë të së cilës ka miratuar shumën e kontributeve për fondin e kompensimit për vitin 2012”.

Autoriteti konstaton, se vendimi i mësipërm është në përputhje me Rregulloren nr. 22, datë 19.03.2010 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”. Në llogaritjen e masës së fondit të kompensimit, janë marrë parasysh treguesit financiar të BSHS-së për periudhën 10 mujore të vitit 2011. Por me mbylljen e vitit financiar 2011, pas nxjerrjes së treguesve të saktë për periudhën 12 mujore të vitit 2011, aktuarët e shoqërive, duhet të kryejnë rillogaritjet duke marrë për bazë vlerat reale për primet bruto, raportin dëme-prime, si dhe numrin e mjeteve të pasiguruara.

Për sa më sipër, Autoriteti,

V E N D O S I:

1. Miratimin e propozimit të BSHS-së për shumën e kontributeve të fondit të kompensimit për vitin 2012, në vlerën totale 150.000.000 lekë, sipas përlogaritjeve të Byrosë bashkëlidhur.
2. Ky fond duhet të derdhet me këste të barabarta tremujore, brenda muajit të parë të çdo tremujori.
3. Brenda muajit prill 2012, BSHS, duhet të depozitojë në Autoritet propozimin për rillogaritje fondit të kompensimit për vitin 2012 duke marrë për bazë vlerat reale për primet bruto, raportin dëme-prime, si dhe numrin e mjeteve të pasiguruara.
4. Ngarkohet Byroja dhe departamentet përkatës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETAR

Enkeleda SHEHI